



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 72prot.

Himarë, më 20.12.2024

**PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË,  
ZBARDHUR NGA ORGJINALI MË DATË 20.12.2024.**

Sot më datë 20.12.2024 zhvillohet mbledhja e këshillit Bashkiak Himarë për muajin dhjetor , mbledhje e hapur, ora 10:30.

Marrin pjesë këshilltarët :

1.Dhimitër Kapaj , 2.Timoleo Gërdhuqi. 3.Mirka Gjiçali , 4.Elisabeta Lamaj, 5. Miltiadh Prifti, 6.Lenica Kocani, 7. Aleks Llazari, 8.Artionil Shirokaj, 9.Fuat Mati, 10. Artan Bala , 11.Thodhori Foto , 12. Loreta Isufi , 13. Silva Burbo , 14 . Nertila Husi , 15.Gjergji Iliadhi , 16.Thëllëza Kokaveshi , 17. Nikolin Laska, 18.Milto Nika , 19.Maks Vlashi , 20. Afrovita Dhimojani , 21. Qirjako Mërkuri mungon.

Plotësohet kuorumi këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit z.Dhimitër Kapaj.

-Përshëndetje! Besoj jeni gati të fillojmë ? Jeni dakort me rendin e ditës?

Znj.Afrivita Dhimojani:- me leje? , për pikën 2 Eleu Sh.P.K nuk jemi dakort.

Kryetari këshillit , në mbledhjen e komisionit e kemi diskutuar dhe kemi rënd dakort të hiqet nga rendi ditës. Vazhdojmë mbledhjen.

**Pika 1.**

Shqyrtimi për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike në Bashkinë Himarë.

Sqaron këshilltari Gjergji Iliadhi. Ne në mbledhjen e komisionit ramë dakort që kjo ndërmarrje të krijohet , të jetë në varësi të Bashkisë.

Sqaron kryetari Bashkisë **z.Vangjel Tavo**:-Përshëndetje, ne gjithmonë jemi për t'i ardhë në ndihmë Bashkisë, për të realizuar objektivat e saj , të kemi ecuri në sezonin turistik, mbarëvajtje në pastrim e një sërë çështjesh të tjera, janë një numër punonjësve shtesë për këtë shërbim.

**Znj.Afrovita Dhimojani** :-Një nga pikat të planifikojë dhe të zbatojë strukturat e nevojshme , jo çdo problematikë do të shkojë në tenderim ,por dua të di çfarë vlere ka ndërmarrja publike? Nga del kjo vlerë?

**Drejtori Laert Mezani**:-Të gjitha këto asete i monitoron kjo ndërmarrje nga buxheti , operohet sipas buxhetit të miratuar. A ka pavarësi financiare vetë ky shërbim? Po, ka :- drejtori L.M Bashkia përcakton këtë lidhje mes shërbimit dhe Bashkisë, kjo ndërmarrje do të operohet në varësi të Bashkisë.

Znj.Afrivita Dhimojani:- të ardhurat e gjeneruar nuk e kuptoj, kuptimi?

Kryetari Bashkisë:- Janë për plazhet

**Znj.Silva Burbo:**-Për ngritjen e kësaj ndërmarrje me organikën e vet , dua të di ,ku do të vendoset kjo ndërmarrje se vetë institucioni nuk i ka këto kapacitete dhe në këtë material duhet të vinte dhe struktura edhe rregullorja , duhej të vinte sot. Kjo ndërmarrje do të përfshijë edhe firmën e pastrimit për tre njësitë sepse me sa di në qershor mbaron tenderimi pastrimit.

**Sqaron kryetari Bashkisë:**-është e drejtë pyetja , kemi menduar provizorisht të ketë godinë te stadiumi dhe juve si këshill të zhvilloni mbledhjet këtu sepse vitin që vjen te fusha sportit do të ngrihet një strukturë edhe për këshillin edhe për ndërmarrjen , kontratën e pastrimit do ta vazhdoj ndërmarrja që e ka.

**Drejtori Laert Mezani :-** Përsa i përket rregullores dhe strukturës është me të hyr në fuqi , meqë kemi kontrata në fuqi që i përcakton ndërmarrja siç janë hapësirat publike, plazhet, e të tjerë , kemi menduar të bëhet në dy faza që të kemi afatet kohore.

**Z.Artionil Shirokaj :-** Kjo ndërmarrje vjen në ndihmë banorëve për probleme të ndryshme , gjë e mirë që u jepet mundësia. Drejtori ndërmarrjes ka përgjegjësi ligjore dhe morale , ne si këshill do ta mbështesim.

**Z.Timoleo Gërdhuqi :-** Duhet parë te shpenzimet ulen kostot apo jo , për uljen e shpenzimeve ku do të ndikojë kjo ndërmarrje ? Drejtori :- e kemi përcaktuar në material jo në vlerë monetare , por procesi kalon në procedurë ,tenderim, në kushtet që jemi me asetet e bashkisë kushton më pak.

**Miratohet vendimi nr 39 me 20 vota pro,“Për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike në varësi më vete, Bashkia Himarë .**

**Pika 2.**

Pika 2 u hoq nga rendi ditës .

**Pika 3.**

**Shqyrtimi i projektvendimit për numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2025**

Kryetari Këshillit pika 3 dhe 4 janë të përbashkëta në shqyrtim.

**Kryetari komisionit Gjergji Iliadhi :-** Komisioni gjatë shqyrtimit të materialit ka dal me vendim të ulët numri punonjësve , të reduktohet.

**Kryetari Bashkisë:-** Në raport me buxhetin nuk ka asnjë lloj ndikimi , kërkojmë që bashkia të përballojë të gjitha kërkesat , numri kërkon të dyfishohet , buxhetin e kemi në 30 milion , qëllimi është t'i shërbejmë komunitetit, të mbledhim çdo qindarkë e për t'i kthyer në shërbim . Kujtoj që ne hyjmë te 10 – të bashkitë me numrin më të ulët të punonjësve

**Kryetari Këshillit :-**Bashkua jonë ka performancën më të mirë për shërbimet.

**Z.Afrovita Dhimojani :-**Ne si komision kërkuam të ulët në 10% nr.punonjësve , ne kemi buxhet të mbartuar nga 2024 , shkojnë në 290 punonjës .

**Sqaron Kryetari Bashkisë:-** Kanë qënë të paangazhuara deri në tetor buxheti i mëparshëm dhe janë zbatuar me prokurime, nuk është kështu si mendoni ju , drejtorit janë për qëllim sa më të mirë për shërbimet .Kjo është tagë e kryetarit të bashkisë. Kush do t'a përballojë gjithë këtë fluks në bashki? Çdo ulje te numëri punonjësve do të ndikojë në uljen e performancës te shërbimeve të Bashkisë.

**Znj.Afrovita Dhimojani:-**Të thuash kemi të trashëguar buxhet i bie nuk janë investuar .Sqaron kryetari :- sido të funksionojë bashkia do të ketë fonde të trashëguara sepse deri në dt .15 tetor trashëgohet.Investimet janë ato që keni miratuar, janë angazhuar deri në masën 90% .Kryetari këshillit :- ju si këshilltare nuk e keni miratuar buxhetin e vitit 2024 dhe situata që kemi kaluar nuk ka nevojë për debat.

**Z.Timoleo Gërdhuqi** :- në një drejtori , institucion ka punonjës me lidhje familjare , psh bashkëshort , familjar ? Sepse ligji nuk e lejon.

**Sqaron drejtori Laert Mezani**:- Ligji i evidenton të gjitha rastet, nuk kemi raste specifike.

**Znj. Afrivita Dhimojani**:- ka punonjës që janë rreth rrethit familjar të punësuar? Drejtori juridik : ka punonjës që kanë lidhje familjare por jo në një institucion .

**Znj.Silva Burbo**:- Nga komisioni dolëm me kongluzion për uljen e numërit të punonjësve , me strukturën e re e rritëm nga 2013 në 290 , ne ulim 20 punonjës , ulje me 20% flasim .

**Sqaron Kryetari Bashkisë** :- nuk është se ky numër punonjësish ka të bëjë me administratën , janë për ndërmarrjen që do të miratojmë, kemi plazhet, kemi parkimet,shërbimet e të tj e të tjerë , shumë pak janë për administratën .

**Kryetari këshillit**:- ne këtë kërkojmë , shërbim të mirë, a do të punojnë këta mikrofonët , a do të ketë administratë të punojë , a do të ketë shërbim më të mirë , më seriozë, policia Bashkiake a do ta kryej më së mirë detyrën si psh;- në mbrojtje të ullinjve, e të tjera e të tjera me radhë, shpresojmë të mos i shohim vetëm nëpër kafenera vitin që vjen.

**Kryetari Bashkisë**:- Kritikat janë me vënd, në këtë afat kohor jemi munduar maksimalisht dhe në 2025 do të marr shërbim çdo banor i bashkisë Himarë.

**Kryetari Këshillit**:- E hedhim në votim propozimin e grupit opozitar dhe të komisionit për të ulur numëri punonjësve në 10%. Po:- Këshilli. (7) shtatë vota janë pro propozimit (13) trembëdhjetë kundra propozimit.

Hidhet në votim pika 3

**Miratohet vendimi nr.40 me (16) vota pro, (4) kundër** ( Silva Burbo, Thëllëza Kokaveshi , Lenica Kocani, Afrovita Dhimojani)

**Pika 4**

**Miratohet vendimi nr .41 me (16) vota pro , ( 4 ) kundër** ( Silva Burbo, Thëllëza Kokaveshi , Lenica Kocani, Afrovita Dhimojani)

**Pika 5**

**Shqyrtimi i projektvendimit për buxhetin e vitit 2025**

**Kryetari këshillit**:- vazhdojmë me buxhetin, si doni ta zhvillojmë me pyetje,diskutime,propozime? Si të doni ju. Dua të falenderoj të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak për miratimet e vendimeve të Këshillit, është fol që në njësinë Horë – Vranisht ka kaluar shumë buxhet edhe pse unë e shikoj buxhetin të përpjestuar në mënyrë të barabartë në të tria njësitë .( Kryetari Këshillit)

Kalojmë në pyetje diskutime :- Kryetari këshillit.

**Znj. Afrovita Dhimojani** :- analizon dhe kërkon që investimet të bëhen afatgjatë, psh, në lagjen "shkallë" , janë investuar kaq herë. Sqaron drejtori shërbimeve Z. Sokrat Kreku.

**Kryetari Bashkisë** :- në Himarë mungon ndriçimi rrugor dhe presim një projekt bashkë me ndriçimin e kalasë , ka investime në Himarë në këtë **buxhet** .

**Znj. Afrovita Dhimojani** :- A janë të mjaftueshme për nevojën që ka Himara? Jo, por me këto të ardhura që kemi jam munduar të mos lë hapësira në ndarje, do të mundohem për ndonjë mangësi të lënë por jo jashtë vëmendjes por jashtë mundësive të bëjmë më të mirën e mundshme.

**Z.Timoleo Gërdhuqi** :- Përmirësimet e shërbimeve gjatë sezonit , sistemet e reja për menaxhimin e mbetjeve se kuptoj?

**Drejtor Laert Mezani** :- Me donatorë të huaj në disa zona të bëhet menaxhimi mbetjeve për çarjen e disa koshave inteligjent, nuk ka impakt financiar.

**Z. Timoleo Gërdhuqi** :- Promovimin e energjisë së rinovueshme , investigimi i familjeve për blerjen e paneleve diellore , mbështetje e iniciativave lokale , projekt për të rinjtë , analiza e detajuar e të ardhurave , a keni planifikuar ndonjë fashën? Për malet plastik, për motorët e ujit ? Këto tarifa janë në paketën fiskale ( drejtori)

- Transparenca për këshillat e qarkut a ka funksionuar ? A ka financuar qarku ndonjë projekt për bashkinë tonë ?
- Në 2024 qarku ka qënë bashkëpunues në aktivitetet kulturore ( drejtori)
- Fondi i emergjencave civile për 2024 a është përdorur dhe ku?
- Drejtori :- përdoret vetëm mbas shpalljes të një fatkeqësie
- Shpenzime qira ,automjete , pse nuk keni parashikuar automjete?
- Drejtori :- në buxhetet e më mëparshëm janë parashikuar, i kemi këste kredie.
- Shpenzime për strehim , sa familje kanë marrë strehim?
- Drejtori :- Administrata në bashkëpunim me qëndrën sociale ka restauruar katë (4) shtëpi .
- Promovim i barazisë gjinore? E diskutojmë në mbledhjen e ardhshme këtë .
- Projektet e bashkimit evropian?
- Drejtori :- po kanë fonde , kanë qënë në vitin 2024 dhe nuk janë lokalizuar , i vendosëm në buxhet se parapaguajmë ne si bashki deri sa vjen fondi nga Bashkimi Evropian .
- Blerje automjete zjarrfikëse, janë 500 milion lekë ?
- Drejtori :- po ,nëse janë rinj kanë këtë vlerë nëse janë të përdorur do të marrim më shumë.

**Znj. Thëllëza Kokaveshi** :-Për të gjitha diskutimet dhe pyetje që foli kryetarja e grupit tonë jam dakort.Nuk jemi kundra miratimit të buxhetit .Erozioni , dua sqarim 300 milion në 2024 dhe 30 milion në 2025 :- **z. Timoleo Gërdhuqi.**

Erozioni nëse do të ishte emergjent pse do të mbartej nga 2024 ?

**Sqaron drejtori Laert Mezani** :- Buxheti realizohet në dy shtylla në blektori dhe ekonomi ,në zonën e bregut kemi ndërhyrje dhe vitin që vjen plani i marshtrimit është detyrim ligjor. **Sqaron drejtori Ilia Gjika**:-këto investime plan marshtrimi do të kalojnë në njësinë Horë – Vranisht , Gjomollë dhe Himarë për parcelat pyjore .

**Znj.Thëllëza Kokaveshi** :- Për buxhetin e arsimit , buxheti i vitit 2024 ku është përfshirë dhe pse vijnë në 2025 kur buxheti i 2024 nuk është realizuar?

**Sqaron drejtori Laert Mezani** :- I kemi përfshirë në lamba për godina publike.

**Znj. Thëllëza Kokaveshi** :- shpenzime për ngrohje shkollash ,lëndë djegëse, detergjente, kancelari , bibliotekë ,e të tj, asnjë nga këto rëza nuk është realizuar në vitin 2024 , ku kanë shkuar?

**Drejtori** :-nuk kemi lidhje kontrate dhe nuk është realizuar .

**Znj. Thëllëza Kokaveshi** :- Mos realizimi buxhetit për arsimin është papërgjegjshmëri e administratës. Buxheti kulturës më duket i fryrë dhe ndërkohë përmend me zëra të gjitha investimet kulturore në bashkinë Himarë ( këshilltarja e lart përmendur)

**Sqaron Kryetari Bashkisë** :- Gjithë buxheti për kulturën e 2024 ka kaluar në 2025, sivjet kemi aktivitet edhe për krishtlindjet, për vitin e ri , kemi aktivitete të tjera ,ne nuk mund të kemi aktivitete kulturore vetëm në verë por të bëjmë të mundur edhe në sezonin e dimrit . Himarën do ta kthejmë në bashki me aktivitete kulturore për të gjithë vizitorët dhe banorët .

**Znj.Thëllëza Kokaveshi** :-Qëllimi i ndërhyrjes time ishte se pse nuk janë realizuar në 2024 këto aktivitete ?

**Z. Timoleo Gërdhuqi** :-Pse nuk janë planifikuar për tri njësitë këto aktivitete ?

**Znj. Silva Burbo** :- Mbështetja sociale, komuniteti , në komunitetin tonë ka njerëz me probleme shëndetësore , mendore, buxheti i kujdesit social është 2 milion lekë të reja Çfarë programesh sociale ka? Njohim njerëz që kanë nevojë për kujdesje , pse nuk del një fond?

**Sqaron drejtori Aida Halili**:-Nuk mund të lëvizim jashtë vendimit të Këshillit të Ministrave . Personat invalid , me aftësi të kufizuar janë të përfshirë ,të parashikuar në planin që do bëjë bashkia së shpejti .

**Znj. Silva Burbo** :- unë propozoj për njerzit me nevoja të veçanta të planifikohet me rastin e fund vitit tu çohet nga një pako ushqimore , të përcaktohet një fond .

**Kryetari Bashkisë** :- jam plotësisht dakort të planifikohet fond për familjet në nevojë .

**Diskutojnë këshilltarët edhe për ndihmën ekonomike e cila ka një vlerë shumë të ulët monetare.**

**Kryetari këshillit** :- ndihma sociale duhet parë , të çohet si vlerë .

**Z.Fuat Mati** :- të dal një fond nga bashkia për të ndryshuar zërat në ndihmën ekonomike

**Z. Timoleo Gërdhuqi** : këto zëra në vijnë në muajin mars , i shqyrtojmë atëherë por ne flasim për ndihmë sociale që të shqyrtohet dhe ta planifikojmë në buxhet , sepse bashkitë e tjera e kanë.

**Drejtori Aida Halili**:- Ne procedojmë në bazë të ligjit .

**Z .Artionil Shirokaj**:- propozoj për çdo fundviti kopshtet të marrin dhurata për fëmijët.

**Z.Milto Nika** :- Jam i rezervuar për këtë buxhet , lidhur me fjalimet e kryetarit për aktivitet e bashkisë Himarë unë mbështes ,, netët e bejkës së bardhë“ por nuk jam dakort me festivalin në Himarë , në Porto Palermo , Borsh , që as ftojnë njerzit por paguajnë bilet që shkojnë atje. Jam dakort për aktivitetet në Himarë , po pse vetëm në Himarë , po në Lukovë? Tek investimet shoh pabarazi sepse ka fshatra që nuk kanë asnjë lloj investimi , të jemi të barabartë, ne jemi zona A.

**Z. Fuat Mati**:-Kemi diskutuar për problemin e ujit në mbledhjen që është zhvilluar në fshatin Tërbaç për në Borsh, është miratuar një projekt nga ujëvara edhe ... se si nuk e di , duhet të jemi më racional, nuk ja filluar si vepër dhe nuk jam dakort me atë projekt , dua që kjo çështje të merret në shqyrtim.

**Kryetari këshillit** :- nuk është kompetencë e jona

**Kryetari Bashkisë**:- Fuat do ta ndjek nga afër si rast

**Kryetari këshillit fillojmë me propozimet për buxhetin.**

Kryetari komisionit të ekonomisë mer fjalën

**Z. Gjergji Iliadhi** :- Nga komisioni ekonomisë dolëm me këto propozime :- 1. mirëmbajtja e rrugës Himarë fshat të bashkohet me sheshin e fshat .2.Rrugët e brendshme të fshatrave Tërbaç , Vranisht të mos realizohen 100% por të merret fond dhe të kalojë restaurimit të rrugës SHKALLË BORSH.

3.Kanalizime të fshatit Nivicë .

**Znj. Afrovi Dhimojani Në emër të grupit** :- Propozojmë rehabilitimi të rrugëve të lagjes Kala – fshat . Rruga e "Merteos" propozojmë t'i kalojë Himarë – fshat dhe të shkurtohet fondi për kostumet popullore.Rruga e Arqiles projektimi. Rrugët e brendshme "Stefanel" të shtohet te vlera e buxhetit të hiqet një pjesë e marshtimit ose te vlera Vuno – Pilur të hiqet një pjesë.Rikonstruksioni i rrugës qëndër – fshat nga qëndra deri te " SHËN E PREMTJA". Shkallët nga porti deri te shkolla kërkojmë restaurim . Për

ekipin sportiv të volejbollit kërkojmë një vlerë rreth 30 mijë euro . Ndriçimin në Bashkinë Himarë.

**Kryetari:** ndriçimi sot është protokolluar dhe do të kryhet.

**Vazhdon z. Afrovita :-**Për këshillin Bashkiak shumë nuk mjafton 10 mijë euro ose 10 milion lekë të vjetra. Kërkojmë një fond edhe për sekretaren e këshillit të pajiset me materialet e nevojshme .

**Kryetari Bashkisë :-** Të gjitha propozimet qëndrojnë, nuk jam absolutisht i ngurt që i propozon opozita përkundrazi se jeni për shërbim të qytetarëve , do të bëjmë ndonjë rregullim, psh:- kostumet popullore të ulet fondi dhe të asokohe te propozimet e Afrovitës. Sheshi Himarës nuk ka plan,( porositë drejtorin ndërkohë kryetari ) , rehabilitimi i rrugëve në qëndër Himarë do ta shikojmë . Për rrugën Argjileo po vazhdojmë. Rrugët e brendshme Stefanel nuk mund të them se çfarë mund të bëjmë por jam dakort të mbyllet njëherë e mirë. Shën e Premte e dija të vendosur në buxhet por në mars do të kalojmë fondin. Shkallët nga porti deri tek shkolla nuk ua premtoj dot . Jam dakort për volejbollin e Himarës një pjesë e kostumeve popullore do të kalojë këtu .Për kancelarin e këshillit do të mbulohet nga bashkia .Të dyfishohet fondi i këshillit nga 10 milion të shkojë 20 milion të vjetra.

**Z. Timoleo Gërdhuqi :-** Këto investime do të mbështeten tek të ardhurat tetor dhe ndryshimet do të bëhen në muajin mars.

**Kryetari këshillit :-** hedhim propozimet më votë.

Hidhen në votim propozimet e komisionit :- Pro të gjithë këshilltarët

Hidhen në votim propozimet e opozitës , Afrivitës :- pro të gjithë këshilltarët .

**Kryetari këshillit :-** Hedhim në votim buxhetin .

**Sa janë pro ?**

**Sa janë kundra?**

**Sa janë abstenim?**

**Miratohet buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2025 me nr.vendimi 42 me 20 vota pro , 0 kundër , zero abstenim.**

## **Pika 6**

**Miratohet ndihma ekonomike me nr.vendimi 43 për periudhën 1 – 30 nëntor 2024 nga fondi i kushtëzuar 6% I bllok – ndihmës ekonomike.**

## **Të ndryshme.**

Shqyrtohet kërkesa e z.Mikeljan Baca , kryetari këshillit lexon kërkesën , dakort këshilltarët.

( Në sallën e këshillit ndodh një problem në rrjetin elektrik dhe ikin dritat ,mbledhja vazhdon nën ndriçimin e telefonave)

**Miratohet vendimi nr.44 për miratimin e marrëveshjes së huapërdorjes për zbatimin e projektit kulturor isopoliforni ,Rok Roll Tunel . Me 20 vota pro, zero kundër , zero abstenim.**

**Znj.Afrovita Dhimojani :-** kemi një ankesë nga banorët e fshatit Pilur për kullotë , për lloj të kafshëve si dhi, derra, Pula, ku janë ngritur ferma afër zonave të banuara, çfarë po ndodh?

**Kryetari Bashkisë:-**Kanë marr sip me qëra dhe kanë të drejtë për shfrytëzim .

**Z.Timoleo Gërdhuqi:-** Ne si këshill duhet të marrim vendim që malli i gjallë të zhvilloj aktivitet rreth 500 m larg banesave.E diskutojmë radhën tjetër në këshill.

**Kryetari këshillit lexon kërkesën e Z. Eqrem Shurdhaj, fshati Bolenë** ku kërkon restaurim të katit të dytë të zyrave të kooperativës shtetërore dhe marrjen me qëra ose blerjen e saj

**Miratohet në parim vendim nr.45 mbi kërkesën e Z.Eqerem Shudhaj,restaurimin e ish zyrave të kooperativës bujqësore Bolenë dhe marrjen me qëra ose blerjen e saj , kati i dytë . ( 20 )vota pro , (0) kundër , (0) abstenim**

**Znj.Afrovita Dhimojani :-** në mbledhjen e radhës si grup kërkojmë të thirret më interpelancë drejtoria IMT për kontrat sezonale në bashkinë Himarë ,bashkëlidhur materialet e detajuara

Kërkesë në interpelancë Kryetarit e Bashkisë , Drejtoria Juridike, gjithë dokumentacioni për sa i përket çështje për fotovoltaiket në Pilur .

Kërkojmë informacion për klubin e natës poshtë urës në Potam

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen dhe uron këshilltarët për festat e fundvitit.

**SEKRETARI**  
**Elena Memushaj**

